

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjermania do të përdorë inteligjencën artificiale për të zbuluar mashtrimet e emigrantëve me ndihmat sociale
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/gjermania-do-te-perdore-inteligjencen-artificiale-per-te-zbuluar-mashtrimet-1586931
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 16:04:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 16:50:07 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6352876667586b51a5bbb5a14d8c41db626c36f0798a0ad92729870f00b03990
TEKSTI	e977a7eeb3fdc0230d187992942b5432b23a2640e7856289df828e7f8aa87d03
PAMJA	609133f18a69fca99e787004efb8f41c3361201e2f5510641e23c6b42c134416

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	737703d196f0dea758ff8b0fec2ba0bcdafd5fc4536312faa4fd2d6d47929f7d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0f7613a812b8a42978251c1471689408cbc054af17ff19ea88699c02ceb99882
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/737703d196f0dea758ff8b0fec2ba0bcdafd5fc4536312faa4fd2d6d47929f7d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 English

Built and Monetized by  [Kontakt](#)



 English



ie 'Krize' ne Izrael, vendi perballiet me mungese trupash dhe pajisjesh ushtarakeKa ky mort e gvyqtaret po mesojne rrogat e tyreZgjedhjet ne Serbi, OSBE e gatshme te mble fundit

Gjermania do të përdorë inteligjencën artificiale për të zbuluar mashtrimet e emigrantëve me ndihmat sociale



18 Shtator 2026, 18:50Bota TEMA



Qeveria gjermane ka shpallur një ofensivë të re kundër abuzimit me ndihmat sociale, duke prezantuar një plan me 37 masa që synojnë të zbulojnë dhe frenojnë mashtrimet me përfitimet që paguhen nga shteti.

Plani, i hartuar nga Ministria e Punës dhe Ministria e Brendshme, parashikon më shumë kontrolle, shkëmbim më të gjerë të të dhënave mes institucioneve dhe përdorimin e inteligjencës artificiale për të identifikuar rastet e dyshuara.

Ministria e Punës, Bärbel Bas, deklaroi se qeveria nuk do të tolerojë më abuzimin me sistemin e ndihmës sociale.

"Ne nuk tolerojmë shfrytëzimin dhe keqpërdorimin e përfitimeve sociale", u shpreh ajo, duke shtuar se qeveria do të përdorë të gjitha mjetet ligjore për të luftuar këtë fenomen.

Sipas Deutsche Welle, një pjesë e madhe e planit lidhet me rastet që autoritetet gjermane i lidhin me emigracionin nga vendet e Bashkimit Evropian.

Sipas qeverisë, në disa raste janë krijuar skema të organizuara ku emigrantë nga vende të BE-së regjistrohen në punë me orar të reduktuar ose edhe në marrëdhënie pune fiktive. Në këtë mënyrë ata fitojnë të drejtën për të marrë ndihmë sociale, pasi të ardhurat e deklaruar rezultojnë shumë të ulëta.

Autoritetet gjermane pretendojnë se pas shumë prej këtyre rasteve qëndrojnë grupe të organizuara kriminale, të cilat sjellin njerëz, kryesisht nga Bullgaria dhe Rumania, i sistemojnë në banesa të amortizuara që shpesh janë në pronësi të tyre dhe më pas përfitojnë nga ndihmat sociale dhe qiratë që paguan shteti.

Pikërisht për këtë arsye, qeveria synon të ndryshojë edhe ligjin për ndërtimet, duke u dhënë autoriteteve më shumë kompetenca për të hyrë dhe kontrolluar objektet ku dyshohet se kryhen këto abuzime. Në raste të caktuara parashikohen edhe mundësi të kufizuara shpronësimi për pronarët që nuk ndërhyjnë në godinat e amortizuara.

Një tjetër ndryshim lidhet me regjistrimin e adresës së banimit. Qeveria synon të shmangë rastet kur dhjetëra persona rezultojnë të regjistruar në të njëjtën banesë vetëm për të përfituar ndihma sociale.

Në plan parashikohet gjithashtu zgjerimi i shkëmbimit të të dhënave mes zyrave të punësimit, bashkive dhe institucioneve të tjera shtetërore. Sipas autoriteteve, kjo do të ndihmojë në zbulimin e punës në të zezë, punësimeve fiktive dhe rasteve të tjera të mashtrimit.

Për herë të parë, qeveria synon të përdorë edhe sisteme të bazuara në inteligjencën artificiale për analizimin e të dhënave. Për këtë qëllim, numri personal i identifikimit do të regjistrohet në të gjitha regjistrat që lidhen me përfitimet sociale, ndërsa institucionet do të detyrohen të shkëmbejnë informacion mes tyre.

Masat parashikojnë edhe që personat ndaj të cilëve ekziston një urdhër arresti i ekzekutueshëm të mos kenë më të drejtë të përfitojnë ndihmën bazë sociale. Po ashtu, punëdhënësit që përdorin punë të padeklaruara do të përballen me sanksione më të rënda.

Problemi është ngritur prej vitesh nga disa qytete të rajonit të Ruhrit, si Duisburg dhe Gelsenkirchen, të cilat kanë raportuar raste kur familje të regjistruara si përfituese të ndihmës sociale nuk jetojnë më prej kohësh në adresat e deklaruara, ndërsa pagesat vazhdojnë.

Bärbel Bas, e cila vjen nga Duisburgu, e ka bërë luftën kundër këtyre skemave një nga prioritetet e mandatit të saj.

Qeveria e kancelarit Friedrich Merz pritet ta miratojë planin gjatë këtij muaji, ndërsa zbatimi i masave mund të nisë deri në fund të vitit.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

"Ndalo rebelët Huthi!" Kina paralajmëron Iranin pas bllokimit të naftës saudite

17:20 Bota

"Kërcënimet e tua janë boshe" - Dhëndri i Donald Trump sfidon Vladimir Putin në zyrën e tij

17:00 Bota

Kriza energjetike, Macron thërret G7: Diskutohet çlirimi i rezervave strategjike

16:40 Bota



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.